



27 MARS 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 27 Mars 2020.

## Përmbajtja

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore” .....	1
Akti Normativ Nr.8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aktin Normativ nr. 3 datë 15.03.2020“ “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.” .....	2
Akti Normativ Nr. 10, datë 26.03.2020 “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar” .....	3

## Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore”.

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[VKM Nr. 243, datë 24.03.2020](#)

Me anë të këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka vendosur shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19. Vendimi parashikon kufizimin e disa të drejtave të garantuara në Kushtetutë deri në masën që do të konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve, përkatësisht si më poshtë:

- Paprekshmëria e banesës (neni 37)
- E drejta e zgjedhjes së vendbanimit dhe lëvizja e lirë (neni 38)
- Shpronësimi kundrejt një shpërblimi të drejtë (neni 41 pika 4)
- E drejta për të zgjedhur lirisht profesionin (neni 49)
- E drejta e grevës (neni 51)

Në VKM janë parashikuar detyrime specifike për institucionet publike, strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile, subjektet private dhe shtetasit.



Individët:

- të zbatojnë urdhrat, masat dhe udhëzimet e autoriteteve të mbrojtjes civile
- të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike
- strukturat e mbrojtjes civile në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë
- të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tyre.

Bizneset:

- të respektojnë procedurat dhe masat për karantinën
- të informojnë lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile
- të përfshihen në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen dhe aftësitë e tyre
- të mos vjelin tarifatat e kalimit rrugor për mjetet e angazhuara në përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

**Akti Normativ Nr.8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aktin Normativ nr. 3 datë 15.03.2020“ “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.”**

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[\*Akt normativ nr. 3, dt. 15.3.2020-Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19\*](#)

[\*Akt normativ nr. 8, dt. 24.03.2020-Mbi rezervat e produkteve ushqimore dhe të tjerave dhe barnave mjekësore\*](#)

1. Krahas strukturave private Spitalore dhe Hoteliere me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rindërtimin, çdo strukturë/objekt tjetër që konsiderohet i domosdoshëm, do të vendoset në dispozicion për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19.
2. Të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë barna/pajisje mjekësore, subjekte që prodhojnë barna dhe pajisje mjekësore dhe subjektet që ofrojnë shërbime shëndetësore, të jenë në gatishmëri dhe të marrin të gjitha masat e

nevojshme për të siguruar furnizime me barna dhe pajisje mjekësore dhe për të ofruar shërbime shëndetësore të nevojshme, në kuadër të përballimit të situatës së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19.

3. Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte ushqimore dhe produkte të tjera, me shumicë, të domosdoshme për përballimin e situatës së epidemisë, janë të detyruar të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19.
4. Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjes vetëm në fasha orare të caktuara dhe të pashoqëruar me persona të tjerë në krah, dënohen me gjobë në vlerën 10'000 lekë, si dhe me mos përfitimin nga paketa financiare e solidaritetit, dhe bllokim për një periudhë 3 mujore të automjetit privat nëse e disponon një të tillë
5. Mos marrja e masave, sipas përcaktimit të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, dënohet me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë dhe me përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Akti Normativ nr.10, datë 26.03.2020 për një ndryshim në ligjin nr.8438, date 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

**[Akti Normativ Nr. 10, datë 26.03.2020 “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar”.](#)**

Mund të shkarkoni dokumentin në link-un e mëposhtëm:

[Akti Normativ Nr. 10, datë 26.03.2020 “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar”.](#)

- Tatimpaguesit mund t'i dorëzojnë pasqyrat e tyre financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në sistemin e tatimeve, brenda datës 31 korrik 2020.
- Për Tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 milion lekë, tatimin mbi fitimin për vitin 2019 mund të paguhet brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020.



- Për Tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 milion lekë, kështu e tatim-fitimit për të katër tremujorët e vitit 2020, mund të parapagohen brenda datës 31 dhjetor 2020.

**Shënim:** Tatimpaguesit duhet t'i dorëzojnë deklaratat e tyre për tatimin mbi fitimin brenda datës 31 Mars 2020. Gjithashtu, tatimpaguesit me qarkullim mbi 14 milion lekë duhet të paguajnë tatim fitimin për vitin 2019 brenda datës 31 Mars 2020, dhe duhet të paguajnë parapagimet e tatim fitimit për vitin 2020 brenda ditës së fundit të çdo tremujori.